



0

**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly**

Komisioni për Shërbime Publike,
Administratë Lokale dhe Media
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.
12.02.2008, ora: 14:00, N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buqinca, Hajdin Abazi, Melihate Tërmkollli, Ali Lajqi, Anita Morina, Rasim Selmanaj, Synavere Rysa dhe Radmila Vujovic.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Drita Morina në cilësinë, zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta, asistente administrative.

Mbledhjen e udhëhoqi Esat Brajshori , kryetar i Komisionit, me këtë:

Rend dite:

1.. Konstituimi i Komisionit

2. Të ndryshme

Pika e parë e rendit të ditës

Esat Brajshori - ai tha se kjo mbledhje ka karakter njohës me anëtarët e komisionit dhe fushat që komisioni i mbulon, duke propozuar që si anëtarë të komisionit të kemi një qëndrim të njëjtë dhe harmonizim të qëndrimeve që dalin si rezultat i debateve me të avancuara gjatë shqyrtimit të çështjeve në fushat që i mbulon komisioni, me qëllim të funksionimit sa më mire të komisionit.

Pika e dytë e rendit të ditës

Në këtë pikë të rendit të ditës kryetari i njoftoi anëtarët e komisionit për dy shkresa të arritura për komisionin, pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit lidhur me këto dy shkresa Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet

- shkresa e komisionit të pavarur të mediave dt.05.02.2008 për emërimin e dy anëtarëve të këshillit të mediave, dhe
- shkresa e TV Mitrovicës -

Për këtë të fundit komisioni vendosi të ftohen përfaqësuesit e KPM-së, përfaqësues të Ampek- ut dhe përfaqësues të TV Mitrovicës.

Kryetari i Komisionit:

Esat Brajshori